

V. Kola



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 1238/2 prot.

Tiranë, më 16.05.2022

URDHËR

Nr. 43/ datë 16.05.2022

PËR

"NGRITJEN E KOMISIONIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT TË
STRATEGJISË PRANË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË"

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës "c", të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të performancës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i përbërë nga 5 anëtarë, si më poshtë:
 - a. Znj. Dëshira Pasko, Kryetar, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm;
 - b. Znj. Eljona Bylykbashi, anëtar, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve;
 - c. Znj. Besmira Hysenbelliu, anëtar, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike;
 - d. Znj. Vilma Kola anëtar, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse;
 - e. Znj. Aulona Levani anëtar, me detyrë Ndhmësinspektor, Njësia e Ndhmës Inspektorëve.
2. Mbledhjet e Komisioni i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë do të zhvillohen një herë në katër muaj dhe në çdo kohë që do të jetë e nevojshme, me kërkesë të Kryetarit.
3. Komisioni i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë ka këto detyra:

- a. koordinon dhe unifikon të dhënat e ardhura nga informacionet e strukturave që raportojnë;
 - b. shqyrton ecurinë e treguesve dhe jep alternativat për nën aktivitetet;
 - c. diskuton dhe përcakton vijimin e punës për çdo aktivitet të strategjisë;
 - d. ndjek publikimin e raporteve katërmujore në faqen zyrtare të institucionit;
 - e. i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nevojën e ndryshimeve të planit strategjik;
4. Në përmbushjen e detyrave funksionale Komisioni i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të asistohet nga Sekretariati Teknik me këtë përbërje:
- a. Znj. Ilma Bici, me detyrë përgjegjës në Sektorit të Përfaqësimit dhe Raportimit;
 - b. Znj. Fjona Përmeti, me detyrë specialist në Sektorit të Përfaqësimit dhe Raportimit.
5. Sekretariati Teknik ka këto detyra:
- a. harton dhe vë në dispozicion të Komisionit raportin e monitorimit;
 - b. parashtron problematikat e hasura nga procesi i raportimit dhe ecurinë e monitorimit;
 - c. ndjek dhe zbaton rekomandimet e Komisionit;
 - d. asiston në çdo mbledhje dhe mban shënime mbi rekomandimet e lëna nga Komisioni.
 - e. ndjek publikimin e raporteve të monitorimit sipas udhëzimeve të Komisionit në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse.
6. Ngarkohet Komisioni i Monitorimit dhe Raportimit të Strategjisë dhe Sekretariati Teknik me zbatimin e këtij urdhri.
7. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani